



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Priljenar/Pradato Received/Delivered	09.12.2020	viti god year	0
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIP/BIK	3051/2020		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A 329/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.329/2020 të datës 27.10.2020 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED], me adresë: Rruga "Orllani", fshati Bardhosh në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.329/2020 e datës 27.10.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED].

II. DETYROHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që të ndër marr veprimet e duhura procedurale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi që rregullon çështjen e shtesave për kushtet specifike në punë, për ankuesen, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

[REDACTED], Inspektore e Tregut, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, më datë 23.10.2020 përmes postës së Kosovës, me numër R 9736787, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore



për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për shkak të kushteve specifike të punës, dhe harmonizimin e pagës nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8). Ankesa e ankueses është pranuar më datë 27.10.2020 dhe është protokolluar me numër 2285/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 29.10.2020 me numër protokollit 2236/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa me datën 06.11.2020 me numër protokollit 2499/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.329/2020, e datës 29.10.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 04.09.2020; Akt Emërimi i datës 22.01.2019; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 11.09.2018; Titujt e vendeve të punës të plotësuara dhe të ndryshuara në katalogun e vendeve të punës në Shërbim Civil të Kosovës: Kërkesat me numër të protokollit 4867/2020 e datës 13.08.2020; Kërkesa e datës 04.09.2020; Kërkesa me numër të protokollit 5865 i datës 03.09.2020; Emali i datës 03.09.2020; Emali i datës 06.05.2020; Emali i datës 14.05.2020; Kërkesa e datës 05.05.2020; Emali i datës 03.09.2020; Emali i datës 07.05.2020; Emali i datës 03.09.2020; Lista e pagave nga data 01.09 deri me datë 30.09.2020; Akt Vendimi me numër të protokollit 1219 i datës 28.02.2020; Aktvendimi me numër të protokollit 5700 i datës 01.09.2020; Raporti i Auditimit për Ministrinë e Tragetit dhe Industrisë për vitin e përfunduar me 31.12.2018; Shkrese lidhur me organizimin dhe funksionimin e inspektoratet në Kosovë; Përgjigja me numër të protokollit 2499/2020 e datës 06.11.2020; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm me numër të protokollit 7078 i datës 17.10.2018; kërkesa me numër të protokollit 4867 e datës 13.08.2020; Vendimi me numër të protokollit 8251 i datës 04.11.2020; Emali i datës 04.11.2020; Emali i datës 22.09.2020; Emali i datës 10.09.2020; Emali i datës 28.10.2020; kërkesa sipas qarkores Buxhetore me numër të protokollit 6531 e datës 25.09.2020; Qarkorja Buxhetore 2021/02, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja [REDACTED] është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të Akt Emërimit të datës 22.09.2018, ka konstatuar se parashtruesja e ankesës mban pozitën e punës Inspektor i Tregut, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Ankuesja ka parashtruar ankesë kundër mosveprimit gjegjësisht mos zbatimit të vendimit nr.5876 të datës 04.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm, për harmonizim të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), dhe kundër mosveprimit në realizimin e shtesës në pagë për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, i publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 10.05.2013.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses për shtesën në pagë për shkak të kushteve specifike në punë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke analizuar legjislacionin në fuqi, ka konstatuar se dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, përkatësisht neni 10.A paragrafi



1 përcakton së: "Inspektorëve të tregut i njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit të punës", andaj, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se ankueses, respektivisht Inspektorëve të Tregut, sipas dispozitave të ligjit të veçantë, iu njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë mirëpo duke u bazuar në paragrafin 2 të këtij neni ku përcaktohet së: Shtesat sipas paragrafit 1. të këtij neni do të bëhet konform Ligjit përkatës për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit përkatës për pagat e nëpunësve civil, Kolegji vlerëson se realizimi i shtesës për kushte specifike të punës për ankuesin mund të bëhet vetëm pas aprovimit nga institucionet përgjegjëse respektivisht Ministria përgjegjëse për administratë publike, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 16 paragrafi 1, ku përcaktohet se: ... *institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civilë, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 7 paragrafi 3 ku përcaktohet se ... për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta, institucioni duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike kërkesën që përmban: 3.1 arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte specifike të punës për pozitën (at) përkatëse; 3.2 listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civilë për çdo pozitë; 3.3 detajet, sipas të cilave, secila pozitë përkatëse pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut; 3.4 koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushte specifike të punës.*

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të bazës ligjore dhe konstatimit se me dispozitat e ligjit të veçantë ankueses i është njohur e drejta në shtesë për kushte specifike në punë, vlerëson se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet të ndërmarr veprimet e duhura procedurale për trajtimin e çështjes që është objekt i kësaj ankese, siç parashihet me dispozitat e nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe dispozitat e nenit 7 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, në këtë kuptim Kolegji ka vendosur për aprovim të pjesshëm të ankesës dhe detyrimin e organit punëdhënës si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankueses për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës për kushte specifike të punës, në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 22.01.2012, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar së Ligji Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, është publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 10.05.2013, ndërsa ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 27.10.2020, andaj vlerëson se pretendimi ankimor për kompensimin e shtesës në mënyrë retroaktive është i pa bazuar për faktin se ankesa është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se; *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8) sipas vendimit nr.5871 të datës 04.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë shqyrtimit të lëndës ka gjetur së ankuesja ka themeluar marrëdhënien e punës në Ministrinë e Tregtisë

dhe Industrisë, në pozitën e punës "Inspektore e Tregut" me koeficient të pagës shtatë (7), sipas Akt Emërimit të datës 22.01.2019. Po ashtu, bazuar në autorizimin e datës 17.09.2018 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil, Kolegji ka konstatuar se koeficienti i pagës për këtë pozitë të punës ka qenë shtatë (7) dhe parashtruesi i ankesës me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës është pajtuar me kushtet e punësimit respektivisht koeficientin e pagës duke nënshkruar Aktin e Emërimit të datës 22.01.2019. Si rrjedhojë, Kolegji ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përmes Vendimit nr.5871 të datës 04.09.2020 ka aprovuar kërkesën e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), mirëpo me datë 03.11.2020 përmes vendimit me numër të protokollit 8251, ka pezulluar zbatimin e vendimit nr.5871 me arsyetimin se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk ka buxhet për harmonizimin e koeficientit të pagës. Andaj, duke marr parasysh se vendimi i lartcekur i organit të punësimit, në mungesë të buxhetit është pezulluar, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr.329/2020

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Ardita AXHNIKAJ-DEMI

Kryetare Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses: ██████████
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë
- Arkivit të KPMSHC-së